



Shtator-Prill 2012/13



Buletin



SH.F.M.U.
"Tefik Çanga"

Ferizaj

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Pak fjalë për shkollën.....	4
Dokumentacioni shkollor.....	5
Ngritja profesionale e mësimeve.....	5
Gjithëpërfshirja.....	6
Binjakëzimi i shkollës.....	6
Grupet punuese.....	7
Mësimi plotësues.....	7
Mësimi shtues.....	8
Punë vullnetare-Trajnime – Mësimeve për mësimeve.....	9
Bibloteka e shkollës.....	10
Bashkëpunimi me komunitetin.....	10
Grantet e fituara.....	11
Bashkëpunimi me organizata - përfitimet.....	11
Aktivitete	13
Përfundimi	14

Hyrja

Fjala e drejtoreshës

Në këtë numër të buletinit të shkollës jemi munduar të përfshijmë të arriturat e punës sonë, duke përfshirë periudhën kohore shtator-prill.

Ideja për hartimin e buletinit erdhi nga stafi i shkollës sepse janë bërë shumë ndyshime pozitive në menaxhimin e mësimdhënies dhe nxënies.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar ngritjes profesionale të mësimdhënësve. Në muajin tetor disa mësimdhënës filluan me programin pashkëputje nga puna. Gjithashtu, nga muaji tetor kanë filluar trajnimin, me indeksin e gjithëpërfshirjes, ku janë të përfshirë një numër i madh i mësimdhënësve. Ky trajnim vazhdon deri në muajin qershor.

Puna vullnetare e mësimdhënësve për ngritje profesionale është duke vazhduar në shkollë dhe çdo javë mbahen nga dy kurse.

Në këtë vit shkollor jemi përfitues të grantit, të bankës botërore dhe kemi përfunduar furnizimin e tri kabineteve; kimi, biologji, fizikë, si dhe me paratë e mbetura kemi shfrytëzuar për llap-top, për nevoja të mësimdhënësve .

Shkolla jonë pati fatin që të binjakëzohet me një shkollë fillore nga Suedia dhe shpresojmë që në të ardhmen të shkëmbejmë përvoja, ide, kulturë gjithnjë, në të mirë të nxënësve.

Nga donacionet e fituara nga USAID është Qendra për ngritje profesionale, klasa e shekullit 21 dhe formimi i grupit të gjelbërve ku janë pajisur me aparatën për riciklimin e shisheve të plastikës. Këto donacione na mundësuan që të bëhet mësim kabinetik me standarde të larta.

Biblioteka e shkollës është funksionale dhe fondi libror është duke u rritur vazhdimisht, duke i falenderuar prindërit, mësimdhënësit ,nxënësit dhe qytetarët, dashamirës të librit.

Pak fjalë për shkollën

Shkolla filloi mësimin sipas vitit kalendarik, më 03/09/2012. Shkolla punon në dy ndërrime.

Gjatë këtij viti shkollor 2012/2013 mësimin e vijnë 1363 nxënës.

Cikli parafillor: 4 paralele me 106 fëmijë.

Arsimi fillor: Klasa e parë: 6 paralele me 152 nxënës, klasa e dytë 5 paralele me 112 nxënës, klasa e tretë 5 paralele me 149 nxënës, klasa e katërt 5 paralele me 138 nxënës, klasa e pestë 5 paralele me 139 nxënës.

Arsimi i mesëm i ulët:

Klasa e gjashtë 7 paralele me 161 nxënës, klasa e shtatë 6 paralele me 144 nxënës, klasa e tetë 6 paralele me 147 nxënës, klasa e nëntë 5 paralele me 115 nxënës.

Në këtë vit shkollor, shkolla numëron 1400 nxënës, prej tyre 270 janë nxënës të komuniteteve. 267 janë ashkali, 2 goran dhe 1 rom.

Numri i punëtorëve të shkollës është 83. Nga këta 71 mësimdhënës, 4 janë staf administrator dhe 9 stafi ndihmës.



Dokumentacioni shkollor

Nga shtatori është duke vazhduar kompletimi dosjeve me dokumentacion pedagogjik për mesimdhënës. Njëkohësisht është duke u grumbulluar materiali i grupeve punuese në portfoliet e tyre. Prezantimet e kurseve të mbajtura nga mesimdhënësit dokumentohen në një dosje të veçantë dhe janë të dëshmuara me fotografi.



Ngritja profesionale e mesimdhënësve

Edhe në këtë vit vazhdon avancimi profesional për mesimdhënës.

Nga tetori filluan ngritjen profesionale me programin pa shkëputje nga puna gjithsej 7 mesimdhënës. Nga cikli i ulët vazhdojnë studimet 3 mesimdhënës, kurse nga cikli i lartë, lëndor 4 mesimdhënës, dy arsimtarë nga lënda e fizikës dhe tre nga lënda e matematikës. Deri më tani këtë program kanë ndjekur tre grupe, ku kanë përfunduar me sukses mbi 20 mesimdhënës.



Gjithëpërfshirja

Për ngritjen profesionale të mësimitdhënësve në gjithëpërfshirje, është duke u zhvilluar seminari nga organizata Save the children, i cili është duke vazhduar. Ky seminar përbëhet prej 8 moduleve.

Ky seminar është bazuar dhe po implementohet në bazë të një udhëzuesi që quhet Indeks. Indeksi për gjithëpërfshirje është një dokument, i cili duhet të implementohet në shkollë përmes punës së vazhdueshme të mësimitdhënësve.

Grupi për gjithëpërfshirje

Është formuar grupi bashkërendues në përbërje prej 10 anëtarëve:

1. Ganimetë Konjufca – drejtorëshë. 2. Adelina Zariqi - pedagoge. 3. Resmije Rashiti - mësimitdhënëse mbështetëse. 4. Diana Marevci - mësimitdhënëse e ciklit të ulët. 5. Luljeta Shabani - mësimitdhënëse e ciklit të ulët. 6. Muhamet Halili - mësimitdhënëse lëndor. 7. Zekije Baftiu - mësimitdhënëse lëndore. 8. Uresa Ahmeti – nxënëse. 9. Ahmet Nazifi – nxënës dhe Musa Baftiu (miku kritik) - drejtor i Qendrës për Mirëqenje Sociale



Binjakëzimi i shkollës

SH.F.M.U “Tefik Çanga” Ferizaj gjatë muajit nëntor është binjakëzuar me shkollën fillore “Grönkulaskulan” Alvesta – Suedi.

Të dy drejtorët e shkollave shprehën dëshirën për kontakte të afërta ngase i përkasin një tipi. Ata deklaruan se: Binjakëzimi i shkollave tona do të jap rezultate të mira në shkëmbimin e ideve dhe përvojave në mes nesh, ne do të përfitojmë më shumë nga përvojat dhe eksperiencat e të dy shkollave tona.

Gjithashtu binjakëzimi në mes shkollave tona do të kontribuoj edhe në gërshetimin e kulturave tona, gjë që me siguri do të paraqes interesim të dyanshëm.



Grupet punuese

Gjatë këtij viti, përpos grupeve ekzistuese, janë formuar edhe grupe të reja punuese si: Grupi i të gjëlberve cili po harton projektin për riciklimin e shisheve. Qëllimi i këtij projekti është: • Të gjithë fëmijët në shkollat e përzgjedhura dhe më tëj, së bashku me familjët, prindërit, mësuesit dhe komunitetin e tyre informohen dhe edukohen plotësisht për rrezikun e madh që shkaktojnë mbetjet, shishet dhe materialet plastike në mjedis. *Shkolla do të jetë e përkushtuar në këtë projekt deri në ndërgjegjësimin e plotë sepse është nevojë e domosdoshme dhe është norme e jetesës që të kemi dhe jetojmë në ambient të pastër.*



Mësimi plotësues


Mësimi plotësues zhvillohet me donacion nga SAVE THE CHILDREN. Kryesisht përfshihen nxënësit që kanë nevojë në mësim dhe për nxënësit që janë në prag të braktisjes. Klasa filloi punën në qershor të vitit 2012 dhe vazhdon punën deri në vitin 2014. Në këtë klasë janë të përfshirë gjithsej 22 nxënës dhe dy mësues të ciklit fillor.

Një mësues (Vehbi Hajdini) mbanë gjithsej 4 orë plotësuese në javë, dy matematikë dhe dy gjuhë shqipe. Kurse mësuesi tjetër (Rexhep Ismani) gjithashtu mbanë 4 orë në javë me aktivitete të lira, me theks të veçantë art figurativ, ku edhe ka themeluar grupin e piktorëve.



Mësimi shtues

Arsimtari i artit figurativ Mujadin Nuhiu ka formuar grupin e piktorëve të rinjë dhe punimet e nxënësve ekspozohen për çdo festë. Gjithashtu arsimtari nga lënda e informatikës ka formuar grupin e nxënësve që kanë talentë dhe mbanë orë shtesë për programe të avancuara jashtë planprogramit mësimor.



Punë vullnetare

Trajnime- mësimdhënësi për mësimdhënësin –

Duke parë nevojën dhe kërkesën për ngritjen profesionale të mësimdhënësve është organizuar një projekt “Mësimdhënësi për mësimdhënësin”, i cili kryesisht përmbanë tema aktuale për ndryshimin dhe reformat në arsim. Kështu që mësimdhënësit vullnetarisht janë paraqitur më tema për të cilat mund të kontribuojnë tek kolegët e tyre. Ky projekt ka filluar dhe është duke vazhduar në mënyrë maratonike deri sa të është e nevojshme që mësimdhënësit të shprehin njohurit, kontributin dhe të sjellin risi duke i modifikuar ato në kushte të shkollës. Temat të cilat janë duke u ligjëruar janë këto:

1. Muhamët Halili-Integrimi i teknologjisë informative (programet aplikative- word, exel, power point). 2. Magbule Berisha- Portfolia. 3. Nexhmije Hoxha- Vlerësimi 4. Luljeta Shabani-Vetëvlerësimi. 5. Valon Sadiku dhe Betim Leka – Llojet e testeve. 6. Sypie Goga dhe Zekije Baftiu- Zbatimi i MKLSH-së gjatë orës mësimore. 7. Vlora Osmani – Hartimi i PZSH dhe i projekteve shkollore. 8. Elhame Murati dhe Muhamet Dërguti- Përpilimi i planit njëvjeçar për seksionin e dramës. 9. Mejreme Berisha- Aktivitetet jashtë mësimore (plan njëvjeçar). 10. Resmije Rashiti- Integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara. 11. Diana Marevci- Integrimi i minoriteteve. 12. Naser Baftiu-Përgatitja e një ore mësimore. 13. Azem Haliti- Vlerësimi i nx. 14. Merita Bytyqi-Prezantimi i një ore mësimore. 15. Hamide Hazrollaj, Fatmire Zahiri dhe Kimete Osmani- Përpilimi i planit njëvjeçar për aktivitetet shkollore. 16. Shefik Ismajli, Skender Krasniqi dhe Nurie Maksuti –Prezantim i punës praktike gjatë orës mësimore. 17. Mihane Grainca dhe Zymer Berisha- Klubi i të gjelbërve (planveprim). Artan Shabani dhe Naim Karaliti-Plani njëvjeçar (grupi i vullnetarëve).



Biblioteka e shkollës

Në shtator, në bibliotekën e shkollës ishin 4236 tituj. Gjatë kësaj kohe numri i titujve ka arritur në 4785 që do të thotë janë shtuar edhe 549 tituj të ri. Dhurimi dhe pasurimi i fondit librar kryesisht është ngritur me kontribut nga nxënësit, prindërit dhe qytetar vullnetar. Sipas statistikave të dhëna shifra e lexuesve arrin në 1200 lexues në muaj.



Bashkëpunimi me komunitetin

Gjatë kësaj periudhe kontributet nga komuniteti i shkollës janë blerja dhe vendosja e perdeve për 20 klasë. Ky aksion është kryesisht nga prindërit.

Ngritja e një aneksi për strehimin e drurëve dhe thëngjillit. Kjo punë është bërë me ndihmën vullnetare të komunitetit dhe punën fizike të kryer nga mësuesit dhe punëtorët ndihmës të shkollës.



Grandet e fituara

Aplikimi në Bankën Botërore për grandin e zhvillimit të shkollave. Ky grand është fituar me vlerë 10.000 euro. Projekti është hartuar, menaxhuar dhe udhëhequr për të gjitha pakot nga koordinatoresha e projektit Vlora Osmani, projekt ky që rezultoi me një përfitim madhor. Tani shkolla jonë është pajisur me inventar dhe mjete për konkretizim për tri kabinete Kimi, Fizikë dhe Biologji.

Gjithashtu, nga ky grand, nga mbetja është përfituar, me pajisjen e 7 llop-topëve për mësimdhënës.



Bashkëpunimet me organizata – përfitimet

USAID- Shkolla jonë plotësoi kushtet për formimin dhe krijimin e qendrës për ngritje profesionale (qendër didaktike) për mësimdhënës në nivel komunal. Qendra është kompletuar me të gjitha pajisjet, duke filluar nga inventari e deri tek mjetet konkretizuese. Qendra posedon 20 llop-top për lehtësimin dhe ngritjen profesionale të

mësimdhënësve Gjithashtu, po nga kjo organizatë është formuar klasa e shekullit XXI, e cila është furnizuar me inventar dhe me të gjitha mjetet për teknologji dhe punë praktike.

UNDP- Nga kjo organizatë kemi fituar projektin – Furnizimi me inventar për dy klasë parafillor. **USAID**-Shkolla nga kërkesa e bërë në këtë organizatë është pajisur me aparat për riciklimin e shisheve. Formimi i grupit të gjelbër pajiset me mjete dhe material shpenzues nga po kjo organizatë, e cila kujdeset për ngritjen dhe vetëdijësimin e nxënësve për mbrojtjen e ambientit.

Save the Children- bën furnizimin me mjete konkretizuese dhe material shpenzues për parafillor, grupin mbështetës për gjithëpërfshirje, dhe mësimin plotësues për nxënësit që kanë ngecje në mësim dhe që janë para braktisjes.



Aktivite



Përfundimi

Gjatë kësaj periudhe kohore shtator-prill është zhvilluar një punë maratonike për ngritjen e nivelit të cilësisë dhe krijimin e kushteve për një mësim cilësor, duke iu përshtatur reformave dhe kurrikulit të Kosovës

Kjo punë është bazuar në tregues, nevoja dhe rezultate, të cilat janë arritur falë një bashkëpunimi të mirëfilltë, duke filluar nga nxënësit, mësime dhënësit, prindërit, dhe komuniteti.

Çdo reformë sjell risi dhe ndryshim në punë. Në jemi për ndryshime dhe do të vazhdojmë duke shfrytëzuar të gjitha resurset dhe potencialet që të arrijmë nivelin e arsimit të lartë në Kosovë dhe me vendet e rajonit.

*Drejtori,
Ganimete Konjufca*

Hartoi:

*Koordinatorja e shkollës,
Vlora Osmani*